

VENDIM
Nr. 37, datë 21.1.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË ORGANEVE
DREJTUESE E TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE
TË EKONOMISË SË MBETJEVE SHA**

(Ndryshuar me VKM nr. 392, datë 28.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., me emrin e shkurtuar “AKEM” sh.a., është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, e themeluar me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuar në ligjin nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., ofron, kundrejt pagesës, shërbimin e trajtimit fundor të mbetjeve dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.

3. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon me dy nivele administrimi, këshill mbikëqyrës dhe administrator, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4. *Kapitali fillestar për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a. është 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.*

5. Ministria e Mjedisit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

- a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;
- b) regjistrimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6. Organet drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit;
- b) Këshilli Mbikëqyrës;
- c) Administratori.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme të Akreditimit dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullohen dhe funksionojnë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe parashikimeve të statutit të shoqërisë “AKEM” sh.a.

7. Këshilli Mbikëqyrës ka 5 (pesë) anëtarë, që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;
- b) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- c) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;
- ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

8. Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, periudha e emërimit apo e riemërimit të tyre, masa dhe skema e shpërblimit caktohen në statutin e shoqërisë, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 167, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

9. Administratori i shoqërisë “AKEM” sh.a., emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë. Kriteret për emërimin e drejtuesit të shoqërisë janë, si më poshtë vijon:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

d) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, prej të cilave 5 (pesë) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;

dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

10. Administratori i shoqërisë “AKEM” sh.a. lirohet nga detyra, kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
- c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;
- ç) humbet shtetësinë shqiptare;
- d) deklarohet i paafte për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

11. Administratori i shoqërisë “AKEM” sh.a., shkarkohet nga detyra kur:

- a) kryen shkelje të rënda të etikës;
- b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- c) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;
- ç) me vendim gjyqësor të formës së prerë i është kufizuar apo hequr zotësia për të vepruar;
- d) nuk përmbush objektivat e shoqërisë;
- dh) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

12. Shoqëria “AKEM” sh.a. realizon objektivat, *mbart të drejtat dhe detyrimet e AKEM-it* dhe ushtron kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe për nevojat e saj mund të nënshkruajë:

a) marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) marrëveshje bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e ndihmës/ekspertizës së nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbetjet apo rritjen e kapaciteteve institucionale;

c) marrëveshje bashkëpunimi me ekspertë të fushave të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Burimet e financimit të shoqërisë “AKEM” sh.a. janë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

14. Struktura dhe organika e shoqërisë “AKEM” sh.a. miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

15. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të shoqërisë “AKEM” sh.a., rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të kësaj shoqërie dhe kriteret specifike të emërimit të punonjësve përcaktohen në aktet e brendshme të shoqërisë.

16. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve do të vijojë të kryejë funksionet e saj, në emër dhe për llogari të ministrit të punëve të brendshme për mjedisin, deri në fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë “AKEM” sh.a.

17. Shoqëria “AKEM” sh.a. njofton me shkrim ministrin e punëve të brendshme për mjedisin për datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.

18. Me mbylljen e veprimtarisë së AKEM-it, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, inventari ekonomik, dokumentacioni dhe arkivi i kësaj Agjencie transferohet pranë shoqërisë “AKEM” sh.a. Për punonjësit aktualë të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, në rastin e mbylljes së institucionit, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

19. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, në artikullin 231 “Shpenzime kapitale”, të programit 06220 “Menaxhimi i mbetjeve urbane”, viti buxhetor 2026. Injektimi i kapitalit fillestar do të kryhet menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

20. Fillimi i ushtrimit të funksionimit të veprimtarisë së AKEM-it si shoqëri aksionare, sipas parashikimeve të këtij vendimi, do të kryhet me shfuqizimin e vendimi nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a.”, të ndryshuar.

21. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama